



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL  
**PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA**  
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.124-2/2025

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Hajriz Hoti kryesues, Kujtim Pasuli dhe Bujar Muzaqi, anëtarë, duke vendosur përkitazi me kërkesën për rishqyrtim të subjektit politik, Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, Anr.124-4/2025, të paraqitur kundër vendimit të PZAP-it Anr.124/2025, në seancën e panelit të mbajtur me datë 19.03.2025, merr këtë,

#### V E N D I M

Refuzohet e pa bazuar kërkesa e subjektit politik, Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë Anr.124-4/2025 e datës 25.01.2025, me të cilën ka kërkuar rishikimin e vendimit të PZAP-it, A.nr.124/2025, të datës 24.01.2025, me të cilin i është shqiptuar dënimi më gjobë në lartësi prej 4,000.00 (katërmijë) Euro, dhe ka detyruar Subjektin politik, Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, që gjobën e shqiptuar si në pikën -II-, të dispozitivit të këtij vendimi, ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi.

#### A r s y e t i m

Paneli me Vendimin Anr.124/2025 të datës 24.01.2025, e kishte miratuar ankesën e Subjektit Politik LVV, parashtruar kundër Subjektit Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, i shqiptohet dënimi më gjobë në lartësi prej 4,000.00 (katërmijë) Euro, dhe ka detyruar Subjektin Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, që gjobën e shqiptuar si në pikën -II-, të dispozitivit të këtij vendimi, ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi.

PZAP-i, me datë 25.01.2025, ka pranuar kërkesën për rishqyrtimin e vendimit Anr.124/2025, nga subjekti politik, Partia Demokratike e Kosovës, me të cilën pretendohet se mbi bazën e prezantimit të fakteve të reja respektivisht pëlqimit nga z. Besim Fazliu në të cilën thekson se i njëjti i ka dhënë pëlqimin kandidatit për deputet, Hajdar Beqa pëlqimin për shfrytëzimin e hapësirës për vendosjen e posterit i cili është objekt i ankesës.

Paneli pas shqyrtimit të shkresave të lëndës vëren se kërkesa për rishikimin dhe anulimin e vendimit Anr.124/2025 e datës;25.01.2025, është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës përkatësisht kërkesa Anr.124-4/2025, e datës 25.01.2025, për rishikimin e vendimit rrjedh se subjekti politik, Partia Demokratike e Kosovës nuk ka arritur që të vërtetojë pretendimet e parashtruara në kërkesë, kjo për faktin se pala ankuese i ka bashkangjitur një dokument jo formal dhe dokument jo i besueshëm për Panelin me emërtimin “pëlqim” i datës 25.01.2025, i lëshuar pas shkeljes së ndodhur, e i cili pëlqim nuk është i lidhur dhe vërtetuar para organeve kompetente, pasi që i njëjti nuk përmban vulë dhe datë të protokollimit të organeve kompetente.

Duke marrë parasysh të gjitha rrethanat e lartcekura vendimi i kontestuar me rishikim, rezulton të jetë i drejtë dhe i ndërtuar mbi fakte dhe prova dhe të mbështetura në dispozitat ligjore në fuqi. Andaj duke u mbështetur në nenin 117.3 të LZP-së ku përcaktohet se: *“vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse”*, Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se nga veprimet e përshkruara në kërkesë dhe nga provat e reja të ofruara si dëshmi parashtruesi i kërkesës nuk ka arritur që të vërtetojë pretendimet e theksuara si më lart.

Ligji Nr.08/L-228, për Zgjedhjet Përgjithshme në Republikën e Kosovës, përkatësisht neni 118 paragrafi 4, me të cilin përcaktohet se *“Vendimi i PZAP-së mund të ankimohet në Gjykatën Supreme të Kosovës, sikurse që PZAP ja mund të rishikojë cilindo nga vendimet e marra, pas prezantimit të fakteve të reja nga pala e interesuar. Ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda dyzet e tetë (48) orëve nga pranimi i vendimit të PZAP-së, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë se pesë mijë euro (5.000 €), ose në rast se çështja lidhet me një të drejtë themelore. Gjykata Supreme e Kosovës vendos në afatin prej pesë (5) ditësh nga paraqitja e ankesës.*

Prandaj PZAP-i, duke u bazuar në arsyet e lartcekura vendosi që kërkesën për rishqyrtim të refuzojë si të pa bazuar në kuptim të nenit 118 paragrafin 4 e lidhur me nenin 115 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Anr.124-2/2025, datë 19.03.2025



Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.